TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. I/20
Dt. 16.03.2018
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

trainkos

Hekurudhat e Kosovës

RAPORT VJETOR 2017

Vendimi: Nr. I/20

Bordi i Drejtorëve i HK "Trainkos" Sh.a njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2017 në mbledhjen Nr. 33 të mbajtur më datë 16.03.2018

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	Gelor Shala Kryeshef Ekzekutiv	Sadik Kryeziu Kryesuesi i BD
Nënshkrimi:		
Data:	15.02.2018	16.03.2018

trainkos

Hekurudhat e Kosovës

RAPORT VJETOR 2017



PËRMBAJTJA

I.	**HYRJE**	3
II.	**RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE**	4
II. 1.	Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes	4
II. 2.	Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenten	7
II. 3.	Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë	8
II. 4.	Komitetet e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.a	9
III.	**FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV**	10
III. 1.	Ngjarjet kryesore të vitit	12
IV.	**PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE**	13
IV. 1.	Transporti i Mallrave	13
IV. 2.	Transporti i Udhëtarëve	16
IV. 3.	Sektori i Mirëmbajtjës	18
V.	**PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET**	20
V. 1.	Gjendja financiare	20
	Tabela 1. Të hyrat dhe Shpenzimet Operative	21
V. 2.	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas Bankës (31.12.2017)	25
V. 3.	Bilanci i gjendjes	25
VI.	**PROJEKTET KAPITALE**	26
VII.	**PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM**	28
VII. 1.	Rreziqet e të ardhmes së korporatës	29
VIII	**STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH.A**	30
IX	**KONTESTET GJYQËSORE**	32
IX. 1.	Kontestet e punës	32
IX. 2.	Kontestet për kompensim dëmi	34
IX. 3.	Kontestet për pagim borxhi	35
IX. 4.	Lëndët përmbarimore	35
IX. 5.	Kontestet gjyqësore të pritura në vitin 2018	36
IX.	**TRANSAKSIONET E REALIZUARA**	37
X.	**PËRFUNDIM**	38

I.	**ANEKS RAPORTI**	
	Raport lidhur me sponsorimet dhe donacionet	
	Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2017	
	Raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve	

I. HYRJE

Gjatë gjithë vitit 2017, kompania kishte një ecuri progresive drejt realizimit të planit operativ dhe financiar. Megjithatë, ndërmarrja edhe gjatë këtij viti është ballafaquar me sfida të shumta dhe të ndryshme, sepse sikurse viteve të kaluara çështja e mbulimit të shpenzimeve të transportit të udhëtarëve nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës vazhdon të mbetet e pa zgjidhur në tërësi. Mirëpo falë angazhimit të palodhshëm të tërë ekipit të HK - Trainkos Sh. A. është arritur që ndërmarrja të ruaj likuiditetin e saj.

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarrjes të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2017. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e kompanisë bashkë me disa prej aktiviteteve të saj. Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë, politikat që ndikojnë në zhvillimin e biznesit si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim pasqyrohet raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore dhe skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2017 i HK - Trainkos Sh.A. ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2017 dhe Raporti i Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve.

II. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Të nderuar aksionarë,

Nga mesi i muajit shtator 2015 është emëruar Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh. A. Që nga kjo periudhë Bordi është angazhuar me përkushtim të lartë që ndërmarrja të ketë kontinuitet të punëve në arritjen e rezultateve në raport me objektivat e planifikuara, angazhim i cili ka vazhduar edhe gjatë viteve në vijim dhe gjatë vitit 2017.

Përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësive ligjore ka qenë fokusi kryesor i Bordit. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Nr. 02/L-123), Bordi i Drejtorëve i Trainkos Sh.a, në emër të aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të. Hartimi i politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për kompaninë si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre ka qenë fokusi kryesor i BD për një qeverisje korporative të ndërmarrjes.

Në saje të angazhimi të të gjithë drejtorëve të bordit nuk kanë munguar as sukseset në përmbushjen e obligimeve. Po ashtu edhe angazhimi i stafit menaxhues është për t'u vlerësuar.

Në vijim, në këtë raport-vështrim do të paraqesim të dhënat mbi aktivitetet, performancën e ndërmarrjes dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vitin 2017.

II. 1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Në këtë pjesë të raportit do të pasqyrohen të dhënat për performancën e ndërmarrjes si dhe sfidat më të cilat jemi ballafaquar. Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes kanë qenë në realizimin e objektivave të planifikuara për vitin 2017 si dhe angazhimi në tejkalimin e pengesave dhe vështirësive tjera.

Një ndër sfidat me të cilat u ballafaquam qysh në fillim të punës sonë, ishte mungesa e mjeteve për të mbuluar shpenzimet në transportin e udhëtarëve, sfidë e cila është duke vazhduar edhe tani. Për shkak të mosmbulimit të shpenzimeve të transportit të udhëtarëve nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës, përkatësisht në mungesë të mjeteve financiare, në muajin korrik ndërmarrja është detyruar që të ndërpresë të gjithë trenat e udhëtarëve në linjën e Pejës dhe atë të Hanit të Elezit. Ndërsa, nga muaji tetor është lëshuar në qarkullim vetëm një tren në Linjën e Pejës pas zotimit të Ministrisë së Infrastrukturës se shpenzimet do të mbulohen.

Përderisa mbulimi i shpenzimeve të transportit të udhëtarëve është definuar qartë me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, kjo çështje ende nuk ka marr zgjidhjen e duhur nga institucionet përkatëse. Çështja e mbulimit të shpenzimeve të transportit të udhëtarëve është njëri prej problemeve që e ka përcjell ndërmarrjen qysh nga ndarja e Hekurudhave të Kosovës dhe si e tillë ende nuk është trajtuar sipas kërkesave ligjore. Mjetet e ndara nga Buxheti i Kosovës për këtë qëllim janë të pamjaftueshme për të mbajtur në qarkullim trenat e udhëtarëve në të gjitha linjat, po ashtu edhe rëniet në transportin e mallrave kohëve të fundit kanë qenë shumë të theksuara të cilat kanë bërë që ndërmarrja të jetë në një situatë tejet të vështirë. Kjo çështje do të jetë sfiduese edhe në të ardhmen dhe paraqet njërin prej shkaqeve më ndikuese në performancën dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Kompletimi me dokumente strategjike e ligjore, mbi bazën e të cilave zhvillohet aktiviteti i ndërmarrjes të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.a gjithashtu ka qenë fokus i Bordit dhe menaxhmentit që t'i përmbushim këto obligime.

- **Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2017**

Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2017 ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Për shkak të gjendjes në ndërmarrje, mosmbulimit të shpenzimeve në transportin e udhëtarëve ndërmarrja ka bërë rishikimin e Planit të Biznesit për vitin 2017.

Përkundër përpjekjeve dhe angazhimit të përbashkët të Bordit dhe të stafit të kompanisë, objektivat e përcaktuara nuk është të arritur të përmbushën gjatë këtij viti në pjesën e transportit të udhëtarëve, ndërsa në atë të mallrave realizimi ka qenë i përafërt me planifikimin. Besojmë që viti 2018 do të jetë më realizim më të mirë dhe presim që çështja e mbulimit të shpenzimeve në transport të udhëtarëve të marrë zgjidhjen e duhur në rastin e rishikimeve buxhetore.

Hartimi i politikave të kompanisë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2017. Janë nxjerrë një serë rregulloresh të cilat definojnë shumë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve si dhe të transportit.

- **Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual**

Gjatë vitit 2017 Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.a. kanë pasur një rezultat jo të kënaqshëm operativ. Në aspektin operativ, në transportin e udhëtarëve, vetëm deri në muajin korrik është arritur të mbajmë në qarkullim 10 trena në linjën e Pejës dhe atë të Hanit të Elezit. Pas kësaj kohe tetë trena janë ndaluar në këto linja shkaku i mungesës së mjeteve financiare. Ndërsa nga fillimi i muajit tetor është lëshuar në qarkullim në vajtje ardhje treni në Linjën e Pejës (dy trena). Ndërsa, në transportin e mallrave realizimi i planifikuar është

arritur në masë të kënaqshme dhe gjithashtu krahasuar me vitin paraprak realizimi ka qenë shumë më mirë.
Sa i përket realizimit financiar në transportin e mallrave gjithashtu kemi qenë afër me planifikimin dhe po ashtu më mirë se sa në vitin paraprak. Ndërsa në transportin e udhëtarëve realizimi financiar nuk është arritur pasi që shpenzimet nuk janë mbuluar të gjitha nga Ministria e Infrastrukturës. Megjithatë, falë mbështetjes së dhënë nga MZHE kemi arritur që vitin 2017 ta përmbyllim me një rezultat pozitiv financiar.

- **Transporti i Mallrave**

Performanca operative në transportin e mallrave, sikurse është e pasqyruar edhe në pjesën tabelare por edhe përshkruese të këtij raporti, është për 16 % neto tonë mallra të transportuara më pak se sa planifikimi, apo për 77 % më shumë se realizimi gjatë vitit 2016.

Performanca financiare nga transporti i mallrave është për 18 % më pak se sa planifikimi vjetor 2017, ndërsa krahasuar me vitin paraprak është për 45 % më shumë.

- **Transporti i Udhëtarëve**

Performanca operative në numrin e udhëtarëve është për - 43.7 % më pak në krahasim me vitin paraprak si dhe për – 34.39 % më pak se sa planifikimi për vitin 2017.

Sa i përket realizimit financiar në transportin e udhëtarëve nga shitja e biletave, përkatësisht të hyrat nga kjo kategori kanë qenë - 43.70 % krahasuar me planifikimin 2017, ndërsa krahasuar me vitin 2016 të hyrat kanë qenë prej -39.29 % më pak. Kjo rënie kaq e lartë në këtë transport ka ardhë si pasoj e ndalimit të qarkullimit të trenave në linjën ë Pejës dhe atë të Hanit të Elezit.

- **Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes**

Një ndër sfidat kryesore për kompaninë Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. mbetet modernizimi i parkut të mjeteve lëvizëse duke pasur parasysh numrin e vogël të këtyre mjeteve që kemi në dispozicion por edhe vjetërsinë e tyre të cilat përveç shpenzimeve të larta për mirëmbajtje kanë edhe shpenzime tjera operuese të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e kostos se përgjithshme.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.a. Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2017 janë shfrytëzuar në disa projekte të rëndësishme, por megjithatë gjendja ende nuk është e kënaqshme sa i përket mjeteve lëvizëse.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh.a

Po ashtu, sfidë e vazhdueshme mbetet përpilimi dhe hartimi i politikave strategjike për zhvillim të kompanisë. Në këtë kontekst, BD është i përkushtuar të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, që projekteve paraprake t'u japë shtytje për realizim.

Gjatë vitit 2018, presim që të arrihet marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës për mbulimin e shpenzimeve në Transportin e Udhëtarëve ashtu siç parashihet me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës.

Gjithashtu vlen të theksohet se shërbimet e veçanta që ofrojmë kërkojnë edhe përgatitje profesionale të veçantë. Andaj, fokus i angazhimeve tona do të jetë përgatitja e kuadrove, qoftë përmes ndonjë iniciative për hapje të drejtimeve shkollore përkatëse në Kosovë, apo edhe përmes trajnimit dhe certifikimit nga institucione e organizata ndërkombëtare relevante.

- **Të priturat për vitin e ardhshëm**

Një prej synimeve tona, padyshim që është planifikimi i investimeve në modernizimin e mjeteve lëvizëse dhe, pse jo, në blerjen e mjeteve të reja. Për ketë jemi të vetëdijshëm se është një mision i vështirë, por me ndihmën e aksionarit dhe me ato pak mundësi tona financiare, pa lënë anash edhe mundësinë për gjetjen e donatorëve apo formave tjera për investim, për këtë qëllim kemi realizuar shumë takime dhe jemi në negociata me disa mekanizma ndërkombëtarë për të siguruar donacione apo forma tjera të përshtatshme dhe të leverdishme për investime në modernizim dhe avancim teknologjik.

Për të përcaktuar nevojat për investime, kompania është e angazhuar në hartimin e një plani afatmesëm për investime.

Përkundër sfidave me të cilat ballafaqohemi, vitin e ardhshëm presim arritjen e objektivave të parapara në planin e biznesit për vitin 2018 siç është rritja e transportit të mallrave vendor dhe ndërkombëtarë si dhe rritje në transportin e udhëtarëve.

II. 2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Përkundër ngecjeve dhe vështirësive që ka pasur në realizimin e projekteve në të kaluarën, gjatë vitit 2017 ndërmarrja ka zhvilluar procedurat për të gjitha projektet kapitale të planifikuara. Projektet janë në fazën finale të realizimit dhe së shpejti do t'i kemi në funksion.

Mjetet për projektet kapitale në shumën prej 1,000,000.00 €, të ndara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2017 janë shfrytëzuar në shumën prej 965,000.00. Po ashtu ndërmarrja edhe me buxhetin e saj ka realizuar disa projekte të rëndësishme.

Një e dhënë tjetër që duhet theksuar është edhe fakti se Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.a. gjatë këtij viti nuk kanë nënshkruar asnjë marrëveshje kredituese gjë e cila na bën të ndihemi mirë pasi që ndërmarrjen nuk e kemi futur në asnjë borxh që do të ndikonte negativisht në zhvillimet e mëtejme.

Mirëpo, është më rëndësi të theksohet edhe fakti tjetër se humbjet financiare të ndodhura në vitin 2016 janë të larta për shkak të mosmbulimit të shpenzimeve në transportin e udhëtarëve nga ana e ministrisë përkatëse dhe ndërmarrja është në obligime të larta financiare për pagesat e qasjes në binarë ndaj menaxherit të infrastrukturës-Infrakos.

Për shkak të kësaj gjendje, ndërmarrja nuk ka arritur atë nivel të realizimit që do të mundësonte shpërndarjen e **dividentës**, (fitimit) ashtu siç është e paraparë me aktet juridike të cilat rregullojnë këtë çështje.

II. 3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO-EKZEKUTIVË

Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A është emëruar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 06/49,të datës 16.09.2015. Në bazë të këtij vendimi si dhe të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Gjatë vitit 2017 në strukturën e Bordit të Drejtorëve kemi pasur disa ndryshime pasi që më datë 22.09.2017 Labinot Halilaj ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij në Bord dhe njëkohësisht edhe nga pozita e Kryesuesit të Komisionit të Auditimit dhe Bujar Hasimi i cili gjithashtu ka lënë detyrën e tij në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 15/05 të datës 29.09.2017.

Gjatë vitit 2017 Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.a ka mbajtur gjithsej 13 mbledhje duke llogaritur edhe Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin. Po ashtu edhe konsultat dhe kontaktet tjera midis drejtorëve të Bordit dhe menaxhmentit të kompanisë kanë qenë të shpeshta.

Në pjesën në vijim do të pasqyrohen të dhënat e vendosura në tabela për strukturën e Bordit të Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe të komiteteve të cilat kanë funksionuar gjatë vitit 2017.

Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë:

PËRBËRJA E BORDIT TË DREJTORËVE TË HK TRAINKOS Sh.a			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Sadik Kryeziu	Kryesues	13
2	Naim Gashi	Anëtar	13
3	Labinot Halilaj	Anëtar deri më 22.09.2017	13
4	Bujar Hasimi	Anëtar deri më 29.09.2017	13
5	Bastri Sallahu	Anëtar	13
6	Mustafa Mustafa	Anëtar	13
7	Gelor Shala	Kryeshef Ekzekutiv	11
8	Afrim Kuleta	Sekretar	13

II. 4. KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE TË HK – TRAINKOS Sh. a.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe arritjes së performancës së kompanisë, punën e Bordit të Drejtorëve e kanë ndihmuar edhe komitetet e krijuara nga vetë Bordi si dhe Komisioni i Auditimit i cili është formuar nga Aksionari.

Kontributi i komiteteve ka qenë tejet i rëndësishëm në definimin e shumë çështjeve dhe lehtësimin e punëve të Bordit. Në pjesën në vijim të këtij raporti do të paraqesim të dhënat për përbërjen e këtyre komiteteve, kohën e funksionimit si dhe numrin e takimeve të mbajtura gjatë vitit 2017.

Të dhënat për Komisionin e Auditimit dhe komitetet e bordit:

Komiteti	Emri dhe Mbiemri		Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMISIONI I AUDITIMIT	1	Labinot Halilaj	Kryesues deri më 22.09.2017	8
	2	Naim Gashi	Anëtar	11
	3	Mustafa Mustafa	Anëtar	11

Komiteti	Emri dhe Mbiemri		Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMITETI PËR HULUMTIME DHE TEKNOLOGJI 31.08.2017 - Aktiv	1	Naim Gashi	Kryesues	3
	2	Bastri Sallahu	Anëtar	3
	3	Gelor Shala	Anëtar	3
	4	Shiqeri Spahiu	Anëtar	1

Në emër të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.a
Sadik Kryeziu – Kryesues

III. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Ndërmarrja HK-Trainkos Sh. a. arriti që vitin 2017 ta përmbyll me vështirësi të mëdha, kjo si rezultat i faktorëve që tanimë dihen siç janë rënia në transportin e mallrave si dhe mos mbulimi i shpenzimeve në transportin e udhëtarëve nga ana e Ministria së Infrastrukturës sipas ligjit 04/L-063.

Përkundër angazhimit të vazhdueshëm të stafit ekzekutiv dhe drejtues të ndërmarrjes për zhvillimin e biznesit dhe përformancës në ndërmarrje, sfidat me të cilat po ballafaqohemi në të shumtën e rasteve vijnë si faktorë të jashtëm dhe kanë ndikuar negativisht.

Qasja vetëm në një portë doganore – linjë ndërkombëtare, ka limituar në masë të madhe mundësinë e rritjes së transportit ndërkombëtar të mallrave (export - import), aktualisht transporti ndërkombëtar hekurudhor zhvillohet vetëm përmes Maqedonisë, kufiri në veri qëndron i mbyllur për arsye të ditura politike edhe pse në aspektin teknik linja hekurudhore është e operueshme.

Tregu i transportit vendor të mallrave ka pasur zhvillim negativ, si rrjedhojë e liberalizimit të tregut duke mos u respektuar rregullat dhe standardet e operimit në transportin hekurudhor. Është krijuar konkurrencë jolojale që ka ndikuar negativisht në përformancen e ndërmarrjes duke pas parasysh që ne si ndërmarrje jemi të obliguar dhe respektojmë të gjitha standardet për operim.

Vazhdojnë të mbetën sfidë, fondet e pamjaftueshme për investime kapitale në modernizimin dhe rritjen e flotës operuese, mjetet me të cilat operojmë janë të vjetra dhe si rrjedhojë krijojnë edhe shpenzime të mëdha.

Sfidat e cekura më lart ndikojnë drejtpërsëdrejti në përformancën e biznesit të ndërmarrjes. Gjithsesi duke u bazuar në këto rrethana, me investim të vazhdueshëm që ndikojnë në uljen e shpenzimeve, duke u përqendruar në zhvillim të vazhdueshëm të ofertës dhe përmirësim koherent të shërbimit dhe njëkohësisht duke e rritur efikasitetin e strukturës organizative, kemi arritur një përformancë biznesore të kënaqshme, siç do të paraqitet në mënyrë të detajuar në raport.

Puna dinamike në funksion të përshtatshmërisë të rregulloreve të brendshme me legjislacionin në fuqi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2017, po ashtu është trajtuar edhe aspekti i përshtatshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregullave ndërkombëtare të operimeve në transportin hekurudhor.

Sa i përket realizimit të detyrave dhe respektimit të afateve ligjore të raportimit, ndërmarrja ka arritur që këto obligime t'i përmbush me sukses. Trainkos Sh.a me kohë ka hartuar Planin e Biznesit, është pajisur me licencat e nevojshme të operimit nga Autoriteti Rregullativ i

Hekurudhave (ARH) dhe në vazhdimësi ka raportuar tek aksionari mbi zhvillimet në kompani.

Kemi ndërtuar një ofertë të mirë për transport hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve, që ofron siguri, saktësi dhe çmime të volitshme dhe konkurruese të tregut. Në të njëjtën kohë jemi angazhuar maksimalisht që oferta jonë të arrijë te çdo klientë potencialë duke përdorur forma të avancuara të promovimit dhe shitjes duke shtuar kujdesin për konsumatorët e shërbimeve tona.

Një prej sukseseve të veçuara gjatë vitit 2017 është realizimi me sukses i projekteve kapitale, ku njeri nga këto projekte është edhe vënia në përdorime dhjetë (10) vagonëve për transportin e udhëtarë, vagonë këta të cilët kanë rritur komoditetin e udhëtarëve të cilët shfrytëzojnë shërbimet tona.

Përkundër realizimit të këtyre projekteve, sfida kryesore për zhvillimin e gjithë biznesit të HK - Trainkos Sh. A. padyshim mbetet investimi në flotën e mjeteve lëvizëse (lokomotiva, vagonë dhe trena motorikë).

Për shkak të gjendjes së mjeteve lëvizëse, vjetërsisë së tyre dhe amortizimit, kërkohen investime emergjente.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2017 janë shfrytëzuar në disa projekte të rëndësishme, por megjithatë gjendja ende nuk është e kënaqshme sa i përket mjeteve lëvizëse.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh. A.

Jemi të përkushtuar që të kemi angazhim maksimal për një zhvillim të gjithmbarshëm të kompanisë. Në kuadër të këtij përkushtimi do të kemi një plan afatmesëm strategjik për zhvillimin e kompanisë dhe ballafaqimin me rreziqet e natyrave të ndryshme të biznesit tonë. Do të vendosim objektiva të qarta mbi mundësinë e zgjerimit të pakos së shërbimeve që ofron kompania, për kompletimin e flotës së mjeteve lëvizëse, për zgjerimin e linjave të transportit dhe do të vazhdojmë me veprime konkrete në kuptim të rritjes së efikasitetit organizativ të kompanisë.

Kryeshef Ekzekutiv
Gelor Shala

III. 1. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

Aktivitetet më të rëndësishme të cilat na kanë shoqëruar gjatë vitit 2017 janë të paraqitura si në vijim:

- Aktiviteti biznesor me partnerët regjional gjatë vitit 2017 kufizohet në vazhdimin e iniciativave për bashkëpunim regjional dhe bilateral me shtetet e regjionit, të kufizuara kryesisht përmes shtetit të Maqedonisë nëse e kemi parasysh lidhjen e vetme ndërkombëtare hekurudhore.

- Insistimi për finalizimin e procesit të gjatë për nënshkrimin e "Marrëveshjes zbatuese për ndërlidhje të rrjeteve hekurudhore ndërmjet Hekurudhave të Kosovës dhe Hekurudhave Maqedonase" dhe "Dispozitat e përbashkëta zyrtare për rregullimin e komunikacionit kufitar hekurudhor në linjën kufitare Hani i Elezit – Vollkovë" vazhdon të respektohet.

- Furnizimi me 10 vagonë të udhëtarëve, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve në transportin e udhëtarëve duke ofruar kushte më të mira për udhëtarët,

- Fillimi i renovimeve të objekteve kryesore të tërheqjes së trenave, me këtë rast rregullohet infrastruktura për punonjësit operativ.

- Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit në mes Doganave të Kosovës dhe Hekurudhave të Kosovës.

IV. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE E TRAINKOS SH.A

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën operative gjatë vitit 2017, duke prezantuar realizimin operativ krahasuar me planifikimin për të njëjtën periudhë dhe me realizimin e vitit paraprak. Po ashtu do të komentojmë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

IV. 1. TRANSPORTI I MALLRAVE

Sektori i transportit të mallrave është njëri prej sektorëve që ka rolin kryesor për ndërmarrjen. Rezultatet e arritura nga ky sektor në vitin 2017 janë prezantuar në vijim, ku sasia e mallrave të transportuara është shprehur në ton:

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	Janar – Dhjetor 2017 - Ton
Realizimi Neto Ton në 2016	**244,648.61**
Realizimi Neto Ton në 2017	**432,329.05**
Planifikimi Neto Ton në 2017	**516,421.00**
Realizim 2017 – Realizim 2016	**187,680.44**
Realizim – Planifikim në 2017	**(84,091.95)**
Realizim 2017 – Realizim 2016 (%)	**77 %**
Realizim 2017 – Planifikim 2017 (%)	**84 %**

Tabela 1.1

Transporti i mallrave me kontejnerë gjatë vitit 2017 ka qenë:

Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontonjerave	Janar – Dhjetor 2017
Kontejnerë të plotë - 2016	**218 copë**
Kontejnerë të zbrazët - 2016	**2 copë**
Kontejnerë të plotë - 2017	**48 copë**

Tabela 1.2

Siç mund të shihet nga tabela 1.1 në këtë periudhë kohore kemi transportuar 77 % më shumë se në të njëjtën periudhë raportuese të vitit të kaluar dhe kemi realizuar 84 % në raport me planifikimin për vitin 2017, vlen te theksohet edhe numri i kontejnerëve te cilët janë paraqitur në tabelën 1.2 është dukshëm me i ultë krahasuar me vitin e kaluar.

Sasia e transportuar për vitin 2017




Figura 1.1

Përshkrimi	Të hyrat në periudhën vjetore 2017 €uro
Realizim shitje të hyra 2016	**582,880.86**
Realizim shitje të hyra 2017	**842,834.98**
Planifikimi 2017	**1,030,000.00**
Realizim 2017 - Realizim 2016	**259,954.12**
Realizim – Planifikim 2017	**(187,165.02)**
Realizim 2017 - Realizim 2016 në %	**45 %**
Realizim – Planifikim 2017	**82 %**

Tabela 1.3

Siç mund të shihet nga tabela 1.3 në këtë periudhë kohore kemi realizuar 45% të hyra më shume se sa në të njëjtën periudhë raportuese të vitit të kaluar dhe kemi realizuar 82 % në raport me planifikimin për vitin 2017.

Të hyrat në periudhën vjetore 2017




Figura 1.2

Ndërsa, nga reflektimi financiar i transportit të mallrave, siç mund të shihet nga shënimet më lart, të hyrat janë 45 % më shumë se sa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë kohore raportuese dhe 82 % kemi realizuar planifikimin për vitin.

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet €
Shitjet nga transporti i mallrave	**842,834.98**
Të ardhura tjera nga transporti i mallrave	**42,997.09**
Total shitjet	**885,832.07**
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	**705,310.21**
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	**229,266.34**
Total shpenzimet	**934,576.55**
Fitimi/humbja në %	**- 5 %**

Tabela 1.4

Të hyrat dhe shpenzimet gjatë vitit 2017




Figura 1.3

Në shitjet nga shërbimet e tjera të transportit të mallrave hyjnë**:**

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet €
Të ardhurat nga transportimi i kontejnerëve me vlerë	**3,840.00**
Të ardhurat nga RIV dhe vendosja me vlerë	**22,527.95**
Të ardhura tjera nga riparimi i vagonëve me vlerë	**10,144.71**
Kompensimi i dëmit	**6,484.43**

Siç shihet nga tabela më lart biznesi i transportit të mallrave ka operuar me rezultat operativ prej - 5**%** gjatë periudhës raportuese.

Vërejtje:

Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave përgjatë vitit 2017, duke marrë për bazë tren - kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e mallrave kanë operuar rreth 20 % nga totali i tren - kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat që kanë qenë për vitin 2017.

IV. 2. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Në fushën e sektorit të transportit të udhëtarëve gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur rezultate jo të kënaqshme krahasuar me vitin e kaluar. Rënia e numrit të trenave të realizuar ka reflektuar me rënie të numrit të udhëtarëve në krahasim me vitet e kaluara por edhe me planifikimin për vitin 2017.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara në periudhën Janar - Dhjetor 2017 me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Në këtë tabelë shihet se kemi rënie të konsiderueshme të numrit të udhëtarëve në këtë vit krahasuar me numrin e udhëtarëve për vitin e kaluar por edhe me planifikimin e vitit 2017.

Përshkrimi - Udhëtarë	Numri i Udhëtarëve
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2016	**278,190**
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2017	**156,618**
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2017	**238,738**
Dallimi: 2017 - 2016	**(121,572)**
Dallimi: realizim - planifikimi 2017	**(82,120)**
Dallimi: 2017 – 2016	**- 43.70 %**
Dallimi: realizim - planifikimi 2017	**- 34.39 %**

Tabela 2.1

Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër më të vogël të udhëtarëve për 43.70 % krahasuar me vitin e kaluar dhe 34.39 % më pak kundrejt planifikimit. Vlen të theksohet se nuk kemi mekanizëm për përcaktimin e saktë të numrit të udhëtarëve që frekuentojnë transportin hekurudhor duke pasur parasysh edhe kategoritë e liruara nga pagesat.

Në tabelën më poshtë është pasqyruar realizimi i transportit të udhëtarëve në vlera financiare:

Përshkrimi - Shitje e Biletave	Të hyrat €
Realizim shitje të hyra 2016	**203,216.27**
Realizim shitje të hyra 2017	**123,382.14**
Planifikimi 2017	**185,676.00**
Dallimi: realizim 2017 - realizim 2016	**(79,834.13)**
Dallimi: realizim - planifikim 2017	**(62,293.86)**
Dallimi: realizim 2017 - realizim 2016	**-39.29 %**
Dallimi: realizim - planifikim 2017	**-33.55 %**

Tabela 2.2

Ndërsa reflektimi financiar i transportit të udhëtarëve, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore, është 39.29 % më pak sesa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë dhe rreth 33.55 % më pak sesa planifikimi i paraparë për këtë periudhë.




Figura 2.1

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve

Përshkrimi - Të hyrat	Janar – Dhjetor €
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - OSHP	1,151,612.81
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - MZHE	744,814.73
Shitjet nga transporti i udhëtarëve	123,382.14
Të hyrat nga shërbimet tjera	1,386.78
Total të hyrat	2,021,196.46
Shpenzimet direkte në TU	1,217,000.51
Shpenzimet indirekte në TU	917,065.34
Total shpenzimet	2,134,065.85
Fitimi / humbja operative ne %	- 5.2 %

Tabela 2.3




Figura 2.2

Siç shihet nga tabela më lart, transporti i udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej **5.2%** gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP[1], MZHE-ja si dhe të hyrave nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara.

[1] Obligimet për Shërbimet Publike

Arsyetim: funksionimi i transportit të udhëtarëve, varet kryesisht nga marrëveshja për shërbimet publike në Ministrinë e Infrastrukturës. Vitin 2017 Trainkos Sh.a e ka filluar me 10 trena në transportin e udhëtarëve, kjo për arsye sepse ministria ka kërkuar që të mos reduktohen numri i trenave ndërkaq në marrëveshje për shërbime publike ka mbuluar vetëm periudhën Janar – Qershor, si rrjedhojë është krijuar situata kur Trainkos në mungesë të mjeteve për mbulimin e shpenzimeve është detyruar të ndërpresë të gjitha linjat e transportit vendor të udhëtarëve, kjo situatë ka vazhduar për dy muaj për të rifilluar funksionimin e reduktuar të numrit të trenave nga dhjete në katër trena.

Këto situata të krijuara si mungesë e zbatimit të ligjit për mbulimin e shpenzimeve të shërbimeve publike ka shkaktuar pasaktësi në planifikimet, zvogëlimin e numrit të udhëtarëve dhe në fund medoemos është krijuar humbje e paevitueshme, duke shpresuar që vitin vijues të kemi mbulueshmëri të plotë të shpenzimeve dhe evitimin e humbjeve.

Vërejtje:

Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për këtë periudhë njëvjeçare duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth 80.00 % nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat që ka qenë për vitin 2017.

IV. 3. SEKTORI I MIRËMBAJTJES

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën nga sektori i mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse gjatë periudhës kohore të raportimit janar - dhjetor 2017.

Në vijim është pasqyruar produktiviteti në shfrytëzimin e fuqisë punëtore se sa dhe ku janë shfrytëzuar këto kapacitete si dhe pasqyrohet raporti në mes fuqisë punëtore në dispozicion dhe fuqisë punëtore të shfrytëzuar.

Shërbimi i mirëmbajtjes së lokomotivave gjatë periudhës janar – dhjetor ka disponuar me fuqi pune prej **18930.00** orë ku:

- **8,043** orë pune, janë shfrytëzuar për riparim apo **42 %** e fondit total të orëve;
- **2,704** orë pune, janë shfrytëzuar për punë ndihmëse dhe dytësore **14 %** e fondit total të orëve;

- Produktiviteti i tërë ka qenë **10,747** orë pune apo **57 %.**

Shërbimi i mirëmbajtjes së vagonëve gjatë periudhës janar – dhjetor ka disponuar me fuqi pune prej **14,649** orë ku:

- **3,665** orë janë shfrytëzuar për riparim apo **25** % e fondit total të orëve;
- **1,764** orë janë shfrytëzuar për punë ndihmese dhe dytësore apo **12 %** e fondit

total të orëve;

- Produktiviteti i tërë ka qenë **5,429** orë pune apo **37%** e totalit te orëve.

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë vitit 2017 për secilin mjet tërheqës është dhëne në tabelën në vazhdim:

Mjtete tërheqëse	2640 - 001	2640 - 002	2640 - 003	2640 - 004	2620 - 005	2640 - 006	2640 - 007	2640 - 008	2710 - 009	2640 - 010	2620 - 016	2760 - 001	2760 - 002	5800 - 001	5800 - 002
S[2]			75		100		57	1		42	64	17		92	122
R[3]			18		17		6		8	8	6	12	2	23	26
K 1[4]			5		8		8			8	2	8		4	6
K 3[5]			2		2		2			2	2	1			1
K 6[6]			1		2		1			2	2	1		1	2

[2] Servisime
[3] Riparime
[4] Kontrollimi njëmujor
[5] Kontrollimi tremujor
[6] Kontrollimi gjashtëmujor

V. PASQYRA E PËRFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

1. Gjendja financiare
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2017)

V. 1. Gjendja financiare

Për periudhën raportuese 2017, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzimeve është siç vijon:

V. 1. 1. Të hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej **842,834.98 €** për vitin 2017. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2017 është **1,030,000.00 €** dhe nga kjo del se kemi realizuar **82 %** nga totali. Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi te realizuara përmes vijës kufitare Hani i Elezit janë **112,865.65 €** dhe nga eksporti po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit të realizuara në vlerën prej **30,082.87 €**. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për "NewCo Ferronikeli" dhe atë në transportin e xehes dhe thëngjillit nga Medveci dhe Kastrioti. Në këtë periudhë nga transporti i këtyre xeheve kemi realizuar vlerën prej **699,886.40 €.**

Transporti i udhëtarëve për vitin 2017 është realizuar në shumën prej **2,020,746.11 €.** Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar me Ministrinë e Infrastrukturës janë **1,151,612.81 €**, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej **744,814.73 €.** Burimi i të hyrave nga biletat është realizuar në shumën prej **124,318.57 €,** shprehur në përqindje me realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi realizuar shumën prej **76.16%,** krahasuar me planifikimin e vitit 2017 – **2,652,968.50 €.**

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë vitit 2017, kanë arritur shumën prej **26,367.95 €.** Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2017, e cila është **50,000.00 €** arrin kuotën prej **52.74%**. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë: Të hyrat e tjera nga kontejnerët dhe shërbimi për te njëjtit – **3,840.00 €** dhe të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet – **22,527.95 €.**

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë vitit 2017, kanë arritur shumën prej **90,944.66 €.** Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet si vijon: Të hyrat nga riparimi i vagonëve të dëmtuar – **17,079.49 €,** të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh. A. – **47,905.71 €,** dhe të

hyrat nga zbritjet e pranuara **25,959.46 €.** Buxheti i planifikuar është **90,000.00 €,** shprehur në përqindjen **101.04%.**

Shuma e donacionit të planifikuar nga Buxheti i Kosovës prej **1,000,000.00 €,** për projektet kapitale të parashikuara gjatë këtij viti është transferuar në vlerë prej **965,000.00 €.**

V. 1. 2. Shpenzimet

Shpenzimet për vitin 2017, ashtu edhe siç janë buxhetuar, janë të klasifikuara në kategoritë si në vijim:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën raportuese është **1,203,529.98 €** nga **1,645,500.00 €** të planifikuara për vitin 2017 dhe arrin kuotën prej **73.14%.** Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2017.

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej **1,705,158.69 €,** dhe atë në paga dhe kontribute – **1,674,841.09 €** dhe sigurimi shëndetësor dhe shpenzime tjera për punëtorë – **30,317.60 €.** Nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar për vitin 2017 – **1,781,000.00 €**, në këtë kategori kemi arritur kuotën e realizimit prej **95.74 %.**

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej **137,999.21 €,** kjo shumë është **70.01%** nga shuma prej **197,100.00 €** e parashikuar për vitin 2017. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2017.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej **39.12%,** konkretisht në shumën prej **52,899.13 €.** Planifikimi për vitin 2017 i kësaj kategorie është **135,200.00 €.** Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2017.


TABELA 1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET OPERATIVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2017

	EMËRTIMI	Realizimi Janar-Dhjetor 2017	Buxheti 2017	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar – Dhjetor 2016
	A	B	C	D	E	F
A	**Shitjet**					
1	**Transporti i mallrave**	**842,834.98**	**1,030,000.00**	**(187,165.02)**	**81.83**	**582,880.86**
2	**TU – Ministria e Infrastrukturës**	**1,151,612.81**	**1,967,292.50**	**(815,679.69)**	**58.54**	**759,766.98**
3	**TU – Ministria e Zhvillimit**	**744,814.73**	**500,000.00**	**244,814.73**	**148.96**	**500,000.00**


	Ekonomik					
4	TU – Shitja e biletave	124,318.57	185,676.00	(61,357.43)	66.95	190,246.78
5	Shërbimet tjera	26,367.95	50,000.00	(23,632.05)	52.74	55,862.80
6	Të ardhurat – riparimi i vagonëve	17,079.49	40,000.00	(22,920.51)	42.69	20,228.20
7	Të hyrat tjera jo operative	47,905.71	50,000.00	(2,094.29)	95.81	49,020.65
I	TOTAL – TË HYRAT	2,954,934.24	3,822,968.50	(868,034.26)	77.29	2,158,006.27
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	526,400.98	750,000.00	(223,599.02)	70.18	589,558.62
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	46,826.48	55,000.00	(8,173.52)	85.14	43,657.51
3	Inventar dhe pajisje	665.31	3,500.00	(2,834.69)	19.01	150
4	Material harxhues	-	1,000.00	(1,000.00)	0.00	0
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	32,279.14	80,000.00	(47,720.86)	40.35	50,626.88
6	Qasja në binarë	509,152.87	665,000.00	(155,847.13)	76.56	544,553.99
7	Sigurimi i palëve të treta	1,627.59	6,000.00	(4,372.41)	27.13	360
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	36,497.91	35,000.00	1,497.91	104.28	43,224.45
9	Shpenzimet e transportit Infrakos	45,017.59	50,000.00	(4,982.41)	90.03	65,646.25
10	Zbritjet e lejuara	4,850.24	-	4,850.24		8,917.53
11	Blerje/shpenzime të tjera	211.86	-	211.86		0.00
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	1,203,529.98	1,645,500.00	(441,970.02)	73.14	1,346,695.23
	Fitimi (humbja) bruto	1,751,404.26	2,177,468.50	(426,064.24)	80.43	811,311.04
	TE ARDHURAT TJERA					
1	Të ardhura të jashtëzakonshme	195,904.45	-	195,904.45		47,221.00
2	Zbritjet e mara	25,959.46	-	25,959.46		6,259.75
3	Të ardhura tjera	72,622.12	-	72,622.12		-
	TOTAL – Te ardhurat tjera	294,486.03	0.00	(705,513.97)	29.45	53,480.75
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	1,674,841.09	1,755,000.00	(80,158.91)	95.43	1,761,366.15
2	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera	30,317.60	26,000.00	4,317.60	116.61	7,789.61
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,705,158.69	1,781,000.00	(75,841.31)	95.74	1,769,155.76
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	27,704.06	30,000.00	(2,295.94)	92.34	4,353.63
2	Sigurimi fizik - total	33,121.91	54,000.00	(20,878.09)	61.34	40,207.10
3	Shërbimet tjera	85.79	200.00	(114.21)	42.90	0
4	Shpenzimet logjistike	29,833.03	18,000.00	11,833.03	165.73	19,144.37
6	Sigurimi i palëve të treta	4,638.26	6,000.00	(1,361.74)	77.30	2,500.77
7	Marketingu	2,499.59	19,500.00	(17,000.41)	12.82	4,141.85
8	Udhëtimet zyrtare	2,893.02	20,000.00	(17,106.98)	14.47	13,845.85
9	Telefonat dhe Posta	21,942.55	27,000.00	(5,057.45)	81.27	20,890.04

10	Shërbimet bankare	916.14	1,200.00	(283.86)	76.35	1,099.13
11	Tatimet	5,915.34	11,200.00	(5,284.66)	52.82	656
12	Pajisje elektronike	5,617.86	10,000.00	(4,382.14)	56.18	17,217.01
13	Shpenzimet e paparashikuara	2,831.66	-	2,831.66		50,774.19
	TOTAL - Shpenzimet operative	137,999.21	197,100.00	(59,100.79)	70.01	174,829.94
E	Shpenzimet administrative					
1	Inventar dhe pajisje	946.44	7,000.00	(6,053.56)	13.52	0
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	2,542.38	5,000.00	(2,457.62)	50.85	6,656.79
3	Material i zyrës	6,167.98	10,000.00	(3,832.02)	61.68	9,688.27
4	Material sanitar	6,023.14	4,000.00	2,023.14	150.58	3,468.07
5	Qiraja për objektet	7,818.55	9,000.00	(1,181.45)	86.87	11,883.03
6	Reprezentacioni dhe bufeja	4,289.65	8,000.00	(3,710.35)	53.62	9,700.05
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	13,587.80	30,000.00	(16,412.20)	45.29	13,119.51
8	Shpenzimet logjistike	2,828.58	17,200.00	(14,371.42)	16.44	3,898.28
9	Kontingjente	8,694.60	45,000.00	(36,305.40)	19.32	2,816.41
	TOTAL - shpenzimet administrative	52,899.13	135,200.00	(82,300.87)	39.12	61,230.41
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	3,099,587.01	3,758,800.00	(659,212.99)	82.46	3,351,911.34
III	Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit	149,833.26	64,168.50	85,664.76	233.49	-1,140,424.32
	GRANTET	918,968.73	936,644.52	(17,675.79)	98.11	939,804.68
F	Shpenzimet e zhvlerësimit					
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	918,968.73	936,644.52	(17,675.79)	98.11	939,804.68
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	24,335.93	62,386.17	(38,050.24)	39.01	45,505.74
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	943,304.66	999,030.69	(55,726.03)	94.42	985,310.42
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	125,497.33	1,782.33	123,715.00	7,041.19	-1,185,930.06

Diagrami 1 – Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit për vitin 2017



Diagrami 2 – Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive për vitin 2017



V. 2. Gjendja në para të gatshme

Nr	EMËRTIMI	Vlera ne €uro
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	10,106.77
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	442,211.16
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	206,228.70
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	30,826.85
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	0.00
7	BPB	5,864.16

V. 3. BILANCI I GJENDJES

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS Sh.a	**GJENDJA FILLESTARE 01/01/17**	**GJENDJA PERFUNDIMTARE 31/12/17**
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	**5,908,644.37**	**6,379,426.00**
Mjetet qarkulluese	**3,505,533.00**	**2,852,290.00**
Stoqet	424,433.42	437,576.00
Paraja	51,046.91	695,291.02
Llogaritë e arkëtueshme	1,807,575.87	1,309,903.34
Kërkesa tjera të arkëtueshme		409,519.64
Parapagimet	1,222,476.80	
Total Mjetet qarkulluese dhe themelore	**9,414,177.37**	**9,231,715.00**
Detyrimet afatshkurta	**1,085,201.18**	**1,562,647.00**
Llogaritë e pagueshme	1,056,070.51	1,544,904.00
Të pagueshme tjera - detyrime		
Detyrime tatimore	29,131.21	17,742.00
Detyrimet afatgjata	**4,908,768.98**	**3,933,999.00**
Kapitali	**4,558,481.61**	**4,709.762.00**
Fitimi/Humbja e bartur	47,655.66	-1,152,116.00
Fitim/ Humbja e vitit	-1,185,930.06	177,423.00
Total detyrimet dhe kapitali	**9,414,177.37**	**9,231,715.00**

VI. PROJEKTET KAPITALE TË HK-TRAINKOS SH. A.

Nr	Titulli i Aktivitetit te Prokurimit	Kontraktuar	Buxheti i zotuar	Vlera e kontratës	Koment
1	Furnizimi dhe instalimi i internetit në vagonë të udhëtarëve	20.07.2017	3,200.00	2,977.00	Përfunduar
2	Furnizimi me kompjuterë monitorë dhe UPS	26.05.2017	2,500.00	2,370.00	Përfunduar
3	Furnizimi me pjesë për automjete	13.04.2017	3,500.00	2,482.50	Përfunduar
4	Sigurimi i automjeteve	20.04.2017	1,950.00	1,932.00	Përfunduar
5	Furnizim me material për vinça për ngritjen e mjeteve lëvizëse	23.04.2017	1,200.00	1,130.44	Përfunduar
6	Furnizimi me papuçe frenuese për vagonë të udhëtarëve	20.04.2017	20,000.00	13,924.00	Përfunduar
7	Shërbimet e mirëmbajtjes së softuerit financiar ALFA	12.06.2017	12,000.00	12,000,00	Në zbatim
8	Furnizimi me vagonë të përdorur të udhëtarëve me riparim të mesëm	2016	1,300,000.00	1,181,666.00	Përfunduar
9	Furnizime me pjesë rezervë të ndryshme me vlera minimale	Janar-Shtator	12,000.00	11,155.00	Përfunduar
10	Kontrollimi sistematik i punëtorëve	13.02.2017	4,200.00	4,200.00	Në zbatim
11	Shërbimet e sigurimit fizik të objekteve të Trainkos Sh.a	18.09.2017	45,000.00	38,868.00	Shkëputur kontrata
12	Furnizim me kompresor për trena motorikë	18.09.2017	2,250.00	2,197.16	Përfunduar
13	Shërbimet e konsulences për matjen e kënaqshmerisë së klientëve	16.07.2017	2,000.00	1,449.00	Në zbatim
14	Furnizimi me filtra për mjete lëvizëse	06.12.2017	9,553.00	9,370.00	Në zbatim
15	Riparimi i jashtëzakonshëm i lokomotivës dizel elektrike 016 të aksidentuar	14.10.2017	41,870.00	27,450.00	Përfunduar
16	Renovimi i objektit të tërheqjes së trenave	05.12.2017	200,000.00	180,414.00	Në zbatim

17	Shërbimet e dezifenktimit, dezinsektimit dhe deratizimit të objekteve, pajisjeve dhe mjeteve lëvizëse të Trainkos Sha	05.12.2017	4,000.00	3,531.00	Përfunduar
18	Furnizimi me naftë	2015	1,000,000.00	691,802.00	Në zbatim
19	Sigurimi i palëve të treta	09.01.2017	2,500.00	1,888.00	Përfunduar
20	Furnizimi me kompjuterë, monitorë, UPS për nevojat e Kompanisë.	05.06.2017	2,500.00	2,370.00	Përfunduar
21	Furnizimi me papuçe frenuese	12.02.2017	7,800.00	7,788.00	Përfunduar

Gjatë vitit 2017 janë realizuar gjithsej nëntë projekte kapitale me vlera të ndryshme kontraktuale. Disa prej këtyre projekteve janë bartur nga vitet paraprake dhe disa tjera janë zhvilluar dhe përfunduar në vitin 2017. Vlera e përgjithshme e këtyre projekteve arrin shumën prej 1,466,378.00 €.

Projektet kapitale të cilat janë ende në zbatim për vitin 2017 dhe të bartura në vitin 2018 është vetëm një i cili parashihet të përfundohet në kuartalin e parë të vitit 2018.

VII. PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

Perspektiva për vitin 2018 është e lidhur ngushtë me objektivat ekonomike të diskutuara dhe precizuara në Planin e Biznesit për vitin e ardhshëm të paraqitura më poshtë.

- Ngritja e vazhdueshme profesionale e kapaciteteve të resurseve njerëzore;
- Ngritja e nivelit të bashkëpunimit të qëndrueshëm me partnerët/operatorët rajonal dhe të vendeve të BE-së në transportin hekurudhor;
- Rritja e cilësisë dhe kualitetit të shërbimit në transportin hekurudhor, për një zhvillim të qëndrueshëm të ndërmarrjes;
- Gjetja e modeleve për financimin e pasurimit/rritjes së parkut të mjeteve lëvizëse sipas strategjisë zhvillimore të kompanisë krahas reformave në sektorin hekurudhor;
- Realizimi i të hyrave në bazë të parametrave të projektuar në Planin e Biznesit 2017 për transportin hekurudhor;
- Angazhimi i vazhdueshëm në shfrytëzimin e të gjitha mundësive për përvetësimin e transportit të mundshëm të mallrave brenda dhe jashtë vendit;
- Të kemi një OShP të aprovuar e që ndikon në mbulimin e humbjeve për transportin e udhëtarëve dhe krijon mundësitë e angazhimit maksimal në ofrimin e shërbimit për transportin e udhëtarëve me saktësi, komoditet dhe çmim konkurrues;
- Aktiviteti në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse në vitin 2018 do të karakterizohet me angazhimin e përhershëm në avancimin e proceseve në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse dhe ndërmarrja e hapave të nevojshëm për certifikimin e punëtorive sipas kritereve të parapara me ERA[7];
- Krijimi i kushteve më të mira për punë që mundëson ngritjen e sigurisë në komunikacionin hekurudhor;
- Zbatimi i Rregullores për transportin e mallrave dhe hulumtimi i tregut që i përket transportit hekurudhorë me një çmim konkurrues;

[7] European Railëay Agency

VII. 1. RREZIQET E SË ARDHMES SË NDËRMARRJES


TRAINKOS Sh.a. që nga procesi i ndarjes dhe fillimi i aktivitetit si Operator Hekurudhor është ndeshur me disa rreziqe që e përcjellin kompaninë në vazhdimësi, e që janë bërë kërcenim edhe për të ardhmen e saj.
Angazhimi ynë në këtë drejtim do të fokusohet në minimizimin e këtyre efekteve të precizuara më poshtë:

- Mos ekzistimi i një Plani të Biznesit afatmesëm të kompanisë;
- Numri i vogël i mjeteve lëvizëse dhe vjetërsia e tyre të flotës ekzistuese të mjeteve lëvizëse;
- Mos mbulimi i shpenzimeve të transportit të udhëtarëve përmes Marrëveshjes së Obligimeve të Shërbimeve Publike (OShP-së) sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës;
- Buxheti i vogël për investime kapitale dhe nevoja e gjetjes së burimeve financiare nëse e kemi parasysh koston e lartë të investimeve në mjetet lëvizëse;
- Kontestet gjyqësore të trashëguara nga Hekurudhat e Kosovës;
- Nevoja e avancimit dhe zhvillimit të proceseve në transportin intermodal dhe përcjellja e proceseve në zbatimin e Strategjisë së Transportit Multi-Modal;
- Gjendja jo e mirë e infrastrukturës hekurudhore dhe kufizimet që shkaktohen në operim qoftë në aspektin e shpejtësisë ashtu edhe në operimin 24/7;
- Futja e operatorëve të rinj në treg;
- Mosfunksionalizimi i segmentit të korridorit të dhjetë

VIII. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH. A.

Operimi me trena në Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. vitin 2017 e ka filluar me një strukturë më të konsoliduar se në vitin 2016. Potenciali njerëzor i punonjësve në fillim të vitit 2017, ka qenë i sistemuar në bazë të përgatitjes së tyre dhe nevojave që ka kërkuar vetë procesi i punës. Shpërndarjes dhe sistemimit të tyre i ka paraprirë skema organizative e kompanisë e cila është ndërtuar në bazë të nevojave të punës të cilën do ta paraqesim në vijim:

Skema organizative e HK-Trainkos Sh. A.



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK – Trainkos Sh.a. është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos Sh.a. më 1 janar 2017 dhe më 31 dhjetor 2017					
Totali i të punësuarve	01.01.2017		31.12.2017		
	237		233		
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje		
Data	01.01.2017	31.12.2017	01.01.2017	31.12.2017	
Mosha mesatare e punëtorëve	46.69	46.61	%	%	
Me marrëdhënie të rregullt pune	237	233	%	%	Format e kontratave
Me kontratë të paafatizuar	107	96	45.14 %	41.20 %	
Me kontratë të afatizuar	130	137	54.85 %	58.79%	
Meshkuj	213	208	89.87 %	89.27 %	Gjinia
Femra	24	25	10.12 %	10.72%	
Serbë	2	2	0.84 %	0.85 %	Nacionaliteti.
Shqiptarë	235	231	99.15 %	99.14 %	
Me shkollim fillor	17	16	7.17 %	6.86 %	Shkollimi
Shkollim të mesëm	129	126	54.43 %	54.07 %	
Kualifikim profesional	24	24	10.12 %	10.03 %	
Me shkollim të lartë	4	4	1.68 %	1.71 %	
Me shkollim superior	63	63	26.58 %	27.03 %	
Departamenti i Operimeve	144	140	60.75 %	60.08 %	Përshkrimi i Departamenteve
Departamenti i Administratës	39	39	16.45 %	16.73 %	
Departamenti i Financave	9	10	3.79 %	4.29 %	
Departamenti i Zhvillimit të Biznesit	5	7	2.10%	3.03 %	
Departamenti i Prokurimit	4	4	1.68 %	1.71%	
Kabineti i KE-së	7	5	2.95 %	2.14 %	
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	20	20	8.43 %	8.58 %	
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	4	4	1.68 %	1.71 %	
Zyra Ligjore	5	4	2.10 %	1.71 %	

Sqarim:

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2017 kemi pasur 10 punësime, 9 pensionime, 3 ndërprerje të një anshme të marrëdhënies së punës, një punëtori i është ndërpre marrëdhënia e punës dhe një punëtor ka vdekur. Gjatë vitit 2017 kemi pasur 9 punëtorë me kontratë për punë specifike, të cilët nuk janë përfshirë në tabelën më lart. Po ashtu në këtë tabelë nuk janë përfshirë as anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

IX. KONTESTET GJYQËSORE

Gjatë vitit 2017 janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme më qëllim të përfaqësimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së interesave të ndërmarrjes si dhe në asistimin në mbikëqyrjen e hartimit dhe implementimit të Rregulloreve dhe akteve juridike të aplikueshme në Trainkos Sh.a.

Përkundër faktit se ndërmarrja në vazhdimësi është ballafaquar me probleme të natyrave të ndryshme rreth ruajtjes së interesave të saj e sidomos sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me kontestet nga kompensimi i dëmeve në të gjitha rastet e aksidenteve të komunikacionit hekurudhor prej të cilave konteste një numër i konsiderueshëm janë trashëguar nga ish - Hekurudhat e Kosovës Sh.a, gjithsejtë 17 raste, në të cilat kemi hasur në parregullsi në përfshirjen e të gjitha provave elementare sa i përket zgjidhjes së kontesteve.

Nga vitet e kaluara, ndërmarrja jonë ka trashëguar gjithsejtë **57 (pesëdhjetë e shtatë)** lëndë**,** ndërsa **10 (dhjetë)** lëndë të reja i kemi pranuar gjatë vitit 2018, pra gjithsejtë jemi në procedurë në **67 (gjashtëdhjetë e shtatë)** lëndë, prej tyre **15 (pesëmbëdhjetë)** janë nga kontestet e marrëdhënies së punës, **24 (njëzet e katër)** janë nga kontestet e kompensimit të dëmit, **4 (katër)** janë nga kontestet për kompensim dëmi ku Trainkos Sh.a. ka cilësinë e paditëses, **4 (katër)** janë nga kontestet për kthim të borxhit ku Trainkos është në cilësinë e paditëses, **4 (katër)** lëndë të kontestit për pagim borxhi ku Trainkos ka cilësinë e të padituërës, **1 (një)** lëndë nga kontesti i Konfliktit Administrativ dhe **15 (pesëmbëdhjetë)** lëndë nga procedura përmbarimore..

Duhet cekur se gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 50 seanca gjyqësore në të cilat ndërmarrja jonë ka qenë palë në procedurë në të gjitha kategoritë e kontesteve gjyqësore.

Duke u bazuar në këtë Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.a. përmes mekanizmave të saj të brendshëm ka ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që të mbrohen interesat e Ndërmarrjes.

Duke u ballafaquar me probleme dhe sfida të tilla gjatë periudhës njëvjeçare kemi arritur rezultate të mira në zgjidhjen e kontesteve në favor të Trainkos Sh.a. si vijon:

IX. 1. KONTESTET E PUNËS

Njëra nga sfidat kryesore të ndërmarrjes Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.a. janë edhe kontestet që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga këto konteste, shumë prej tyre janë të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës.

Nga kontestet e punës gjatë kësaj periudhe Trainkos Sh.a. është përfaqësuar në katër konteste gjyqësore.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:
1.	C.nr.212/2015	8,948.00 €	E paditur
2.	C.nr.190/17	/	E paditur
3.	C.nr.291/17	41,500.00 €	E paditur
4.	C.nr.607/14	/	E paditur

Po ashtu gjatë kësaj periudhe nga kontestet e punës kemi pranuar gjashtë aktgjykime dhe tri aktvendime.

AKTGJYKIM

Nr.	Nr. lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	C.nr.345/14	43,326.57	E paditur	Refuzohet kërkesëpadia e paditëses. Pritet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit sipas ankesës së paditëses
2.	AC.nr.4404/14	41,500.00	E paditur	Lënda në rigjykim
3.	Rev.nr.374/16	24,445.00	E paditur	E përfunduar në favor të Trainkos Sh.a.
4.	Ac.nr.2606/14	23,566.44	E paditur	E përfunduar në favor të Trainkos Sh.a.
5.	AC nr.857/16	10,106.50	E paditur	Gjykata e Apelit e Kosovës e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka Vërtetuar aktgjykimin C.nr.2671/2012 i cili është në favor të Trainkos Sh.a.
6.	AC nr.3708/15	/	E paditur	Gjykata e Apelit e Kosovës e ka refuzuar ankesën e Trainkos Sh.a. dhe ka Vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë C.nr.378/08 të dt.20.02.2015 i cili është në favor të paditësit

AKTVENDIM

Nr.	Nr. lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	AC.nr.3962/13	/	E paditur	Lënda në rigjykim
2.	AC.nr.2141/14	/	E paditur	Lënda në Gjykatën Supreme të Kosovës
3.	C.nr.190/17	/	E paditur	Padia e tërhequr
4.	C.nr.2043/16	/	E paditur	Në procedurë në shkallën e parë

Prej kontesteve të punës të përfunduara në favor të Trainkos Sh.a. gjatë vitit 2017 kemi tri konteste.

Nr.	Nr. lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	Rev.nr.143/17	23,566.44	E paditur	E përfunduar në favor të Trainkos Sh.a.
2.	C.nr.190/17	/	E paditur	Padia e tërhequr
3.	Rev.nr.374/16	24,445.00	E paditur	E përfunduar në favor të Trainkos Sh.a.

IX. 2. KONTESTET PËR KOMPENSIM DËMI

Nga kontestet e kompensimit të dëmeve gjatë periudhës janar - dhjetor Trainkos Sh.a. është përfaqësuar në 9 konteste.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:
1.	C. nr. 191/2007	500.00	Paditëse
2.	IC. nr.535/2014	19,515.00	Paditëse
3.	C. nr. 286/2009	100,000.00	E paditur
4.	C. nr. 1954/2010	22,000.00	E paditur
5.	C. nr. 25/ 2016	15,000.00	E paditur
6	III.EK.nr.155/2016	10,742.49	Paditëse
7	C. nr. 1111/13	4,500 .00	E paditur
8.	IV.EK.nr.381/15	16,703.00	E paditur
9.	C.nr.1145/15	166,500.00	E paditur

Prej këtyre kontesteve dy janë zgjidhur në favor të Trainkos Sh.a..

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera €	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:
1.	C.nr.191/2007	500.00	Paditëse
2.	C.nr.25/ 2016	15,000.00	E Paditur

Gjatë kësaj periudhe kemi pranuar dy padi të reja për kompenzim dëmi

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera €	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:
1	C.nr.724/17	50,000.00	E Paditur
2	C.nr.155/14	4,500.00	E Paditur

Gjatë vitit 2017 nga kontestet e kompensimit të dëmeve kemi pranuar një aktgjykim i formës së prerë dhe tre aktvendime në favor të ndërmarrjes.

AKTGJYKIM

Nr.	Nr. lëndës	Vlera €	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:	Veprimet e ndërmarra

1.	C.nr.191/2007	500.00	Paditëse	Aktgjykimi i formës së prerë C.nr.191/2007 i datës 02.02.2017 i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë

AKTVENDIM

Nr.	Nr. lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:	Veprimet e ndërmarra
1.	C.nr.25/2016	15,000.00	E Paditur	Paditësi ka tërhequr padinë
2.	Ac.nr.2215/2016 C.nr.1200/15	31,077.60	E Paditur	Është refuzuar ankesa e paditësve si e pa afatshme
3.	Ac.nr.4664/2015	270.00 rentë mujore	E Paditur	Lënda në rigjykim

IX. 3. KONTESTET PËR PAGIM BORXHI

Nga kontestet e borxhit gjatë këtij viti Trainkos Sh.a është përfaqësuar në katër konteste.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera €	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:
1.	IC.nr.212/2015	4,211.00	Paditëse
2.	IC.nr.184/2015	15,322.65	Paditëse
3.	C.nr.221/2015	55,000.10	Paditëse
4.	II.EK.nr.171/2015	3,553.20	Paditëse

Nga kontestet e borxhit gjatë kësaj periudhe një kontest ka përfunduar në favor të Trainkos-Sh.a.. me aktgjykim të formës së prerë.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera €	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:
1.	IV.C.nr.459/15	2,370.00	E paditur

IX. 4. LËNDËT PËRMBARIMORE

Sa i përket lëndëve në procedurë përmbarimore Operimi me Trena Trainkos Sh.a. gjatë vitit 2017 është përfaqësuar në gjithsejtë në 10 lëndë, ku në 8 prej tyre Trainkos Sh. a. është në cilësinë e debitorit ndërsa vetëm në një lëndë ka cilësinë e kreditorit dhe atë në procedurë të kundërpërmbarimit.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh.a ne cilësinë e:	Veprimet e ndërmarra
1.	P.nr.283/17	3,852.00	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
2.	P.nr.313/17	2,342.00	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
3.	P.nr.609/17	125,521.95	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
4.	P.nr.463/15	5,222.54	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
5.	P.nr.132/17	3,697.75	Debitor	Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në favor të Kreditorit, mjetet janë ekzekutuar
6.	PPP.nr.535/16	2,000.00	Debitor	Është ushtruar Ankesë, lënda gjendet në Gjykatën Apelit në Prishtinë
7.	P.nr.299/17	4,657.84	Debitor	Është ushtruar ankesë, lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
8.	P.nr.310/17	1,744.32	Debitor	Është ushtruar ankesë, lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
9.	CP.nr.292/16	244,814.52	Kreditor	Është ushtruar prapësim nga debitori lënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë
10.	P.nr.359/17	500.00	Kreditor	Lënda është në përmbarim

IX. 5. KONTESTET GJYQËSORE TË PRITURA NË VITIN 2018

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.a. në vitin 2018, pritet të ballafaqohet me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) konteste gjyqësore. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve të hapura dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të kemi ftesë nga gjykatat gjatë vitit 2018:

Kategoritë e kontesteve për vitin 2017	
Kontestet nga marrëdhënia e punës	15
Kontestet për kompensim të dëmit	28
Kontestet për pagim të borxhit	8
Kontestet administrative	1
Lëndët nga procedura përmbarimore	15

Në bazë të kësaj gjendjeje, kontestet gjyqësore mbesin si një ndër rreziqet më të mëdha të kompanisë pasi që kontestet gjyqësore janë në numër shumë të madh si dhe me vlera të larta financiare. Në rast të humbjes të ndonjë kontesti kompania do të dëmtohet financiarisht. Kontestet janë si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë të kompanisë sa ishte nën administrim të UNMIK-ut dhe një pjesë e madhe edhe pas daljes së kompanisë nga administrimi i UNMIK.

X. TRANSAKSIONET E REALIZUARA

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	Euro €
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2017	19,093.08
Pagesat e kryera për vitin 2017	1,505,864.49
Inkasimet e pranuara për vitin 2017	1,496,878.18

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	Euro €
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2017	0.00
Inkasimet e pranuara për vitin 2017	1,160,000.00
Pagesat e kryera për vitin 2017	717,788.84

XI. PËRFUNDIM

Trainkos Sh.a gjatë këtij viti është përpjekur maksimalisht në përmbushjen e objektivave të paraqitura në planin e biznesit, duke pasur parasysh gjendjen jo të mirë të cilën kemi qenë gjatë vitit 2016, këtë vit kemi arritur që të përmbushim pjesën dërmuese të objektivave në transportin e mallrave, në veçanti rikthimin e transportit vendor të xehes së nikelit për kompaninë NewCo Ferronikel, si njëri prej klientëve tonë kryesor dhe strategjik.

Sfidë në vete vazhdon të mbetet transporti ndërkombëtar i mallrave (eksport-import) ku edhe përkundër ndryshimeve të bëra në rregulloren e transportit duke ofruar çmime më të volitshme dhe shërbime më cilësore vazhdon të mbetet në nivele jo të kënaqshme, mirëpo duke pasur parasysh që kësaj gjendje i paraprijnë shumë faktorë të jashtëm për të cilët e kemi vështirë t'i evitojmë mbetemi me shpresë në përkrahjen institucionale që kontribuon në hartimin e politikave strategjike të cilat do të nxisnin rritjen transportit të mallrave të transportuara përmes hekurudhës, gjithashtu faktor tjetër shumë i rëndësishëm që duhet cekur është edhe pamundësia e operimit në drejtim të Serbisë, si segment shumë i rëndësishëm për qasje më të lehtë dhe më të shpejt në shtetet Evropiane, faktor i cili ka ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e kësaj situate.

Në transportin e udhëtarëve këtë vit, ashtu si në vitet paraprake Trainkos Sh.a. nuk ka arritur objektivat e përcaktuara me planin e biznesit, i cili vjen si rezultat i mosmbulimit të shpenzimeve nga ana e Qeverisë siç është përcaktuar me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës. Trainkos Sh.a, nga këto rrethana ka qenë i detyruar te zbatoj politiken e kursimit, e në pamundësi të operimit normal në të gjitha vijat e aprovuara në fillim të vitit është detyruar ne ndërprerjen e tetë trenave deri në përmbushjen e obligimeve ligjore nga ana e Qeverisë.

Përgatitja e Planit të Biznesit pesëvjeçar me pjesëmarrje aktive të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik do të mundësonte projektimin e domosdoshëm të politikave për ofrimin e transportit hekurudhor të udhëtarëve në linjat e aprovuara dhe në zbatimin e konceptit bazik për zhvillim ekonomik të Kosovës për transportimin e mallrave specifike dhe me pesha të rënda përmes hekurudhës.

Duke pasur parasysh se transporti hekurudhor është një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit industrial dhe ekonomik të vendit, besojmë se qeveria e Kosovës duhet ta vë në prioritet investimin në këtë sektor duke siguruar qëndrueshmëri për operatorin HK-Trainkos Sh. A.

Planifikimet strategjike për sektorin hekurudhor kanë lënë të padefinuar problematikën e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore për të cilën duhet të punohet me precizitet në proceset e hartimit të një Plani të Biznesit tre apo pesë vjeçar për TRAINKOS-in. Kjo nëse kemi parasysh planifikimet e Qeverisë të precizuara në "Strategjia Sektoriale dhe Transporti Multimodal 2015–2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar" për ofrimin e mundësisë së modernizmit të flotës së mjeteve lëvizëse sipas proceseve tjera reformuese në sektorin

hekurudhor. Sfidë tjetër në këtë proces është edhe angazhimi në ngritjen e nivelit profesional të stafit dhe kapaciteteve sipas standardeve të kërkuara.

Mbesim të përkushtuar maksimalisht në angazhimet tona të përditshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të ndërmarrjes dhe ofrimin e shërbimeve sa më të mira për klientët tanë si në Transportin e Mallrave ashtu edhe në Transportin e Udhëtarëve.

Fushë Kosovë,
16.03.2018

